



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2254/2 Prot

Rrëshen, më 29 . 05 . 2026

**V E N D I M**

**Nr. 40 datë 26. 05. 2026**

**P Ë R**

**“NJË SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2026, SIPAS SHKRESËS SË MINISTRISË FINANCAVE, NR. 6822/1 PROT, DATË 04.05.2026, ME OBJEKT: “TRANSFERIM FONDI PËR SHPENZIME KAPITALE”, PËR PAGESË TVSH DHE BASHKËFINANCIM, PËR PROJEKTET “MIRDITA - JUNIK & EFFORT”, BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimin nr. 9, datë 20. 07. 2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, “Për zbatimin e buxhetit 2026”, shkresa e Ministrisë Financave, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike, nr. 6822/1 prot, datë 04.05.2026, me objekt: “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, shkresa e Njesisë për Koordinimin e Integritimit Evropian dhe Projekteve nr. 2249 prot, datë 20.05.2026, *Relacion nr. 2254 prot, datë 21.05.2026, tabelat së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 25.05.2026, të Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit, për t’ia kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;*

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë përdorim fondi të çelur me shkresën e Ministrisë Financave, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike, me nr. 6822/1 prot, datë 04.05.2026, me objekt: “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, si më poshtë;

A. Shtesë fondi në buxhetin e vitit 2026; (bashkëfinancim dhe pagesë TVSH)

A.1 Projekti; MIRDITA – JUNIK:

- AD133.....2133001.....01.....602.....V476AAB.....1 440 277 lekë
- AD133.....2133001.....01.....230.....V476AAB.....296 715 lekë
- AD133.....2133001.....01.....231.....V476AAB.....8 012 794 lekë

**TOTAL PROGRAMI AD133.....9 749 786 lekë**

ADRESA: SHESHI “ABAT DOQI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

**A.2 Projekti; EFFORT:**

- AD133.....2133001.....01.....230.....V476AAB.....229 200 lekë
- AD133.....2133001.....01.....231.....V476AAB.....13 352 802 lekë

**TOTAL PROGRAMI AD133.....13 582 002 lekë**

**TOTAL SHITESË BUXHETI;.....23 331 786 lekë**

2. Shkresa e Njesisë për Koordinimin e Integritimit Evropian dhe Projekteve nr. 2249 prot, datë 20.05.2026, Relacion nr. 2254 prot, datë 21.05.2026, së bashku me tabelat, *bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi*
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë; (Drejtoria Juridike, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksat & Njësia për Koordinimin e Integritimit Evropian dhe Projekteve)

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**SEKRETAR**

**Gaspër TOPOLLAJ**



**KRYETAR**

**Aleksandër PICAËU**





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr. 2254 / prot  
/1

Rreshen me 21/05 /2026

P/V E N D I M

Nr. 51 date 21.05.2026

**“PËR NJË SHTESE NË BUXHETIN E VITIT 2026, SIPAS SHKRESES SE  
MINISTRISE SE FINANCIVE, NR.6822/1 PROT, DATE.04.05.2026, ME OBJEKT  
“TRANSFERIM FONDI PER SHPENZIME KAPITALE”,  
PËR PAGESE TVSH DHE BASHKEFINANCIM , PER PROJKTET “MIRDITE  
JUNIK DHE EFFORT” .**

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", 87/2025, "Per buxhetin e vitit 2026" "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", ne shkresen e Ministrise se Financave , Drejtorise se Buxhetit, Drejtorise se menazhimit te Investimeve Publike, nr.6822/1 prot, date.04.05.2026 me objket "Transferim fondi per shpenzime kapitale", shkrese se sektorit te per kordinimin e integrimin evropian dhe projekteve nr.2249prot, date.20.05.2026, Këshilli i Bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkise;

**V E N D O S I:**

*I-Përdorimin e fondit të çelur me shkresen e Ministrise se financave , Drejtorise se Buxhetit, Drejtorise se Menazhimit te Investimeve Publike, nr.6822/1 prot, date.04.05.2026 me objket "Transferim fondi per shpenzime kapitale"(bashkelidhur), si me poshte:*

**A-SHTESE FONDI NE BUXHETIN E VITIT 2026(bashkefinancim dhe pagese TVSH)**

***A/1-Projekti: MIRDITA JUNIK:***

***Shtese buxheti:***

-AD133.....2133001.....01.....602.....V476AAB.....1 440 277 leke

-AD133.....2133001.....01.....230.....V476AAB.....296 715 leke

-AD133.....2133001.....01.....231.....V476AAB..... 8 012 794 leke  
**TOTAL PROGRAMI AD133.....9 749 786 leke**

**A/2-Projekti: MIRDITA EFORT:**

Shtese buxheti:

-AB133.....2133001.....01.....230.....V644AAB.....229 200 leke

-AB133.....2133001.....01.....231.....V644AAB.....13 352 802 leke

**TOTAL PROGRAMI AB133.....13 582 002 leke**

**TOTAL SHTESE BUXHETI.....23 331 786 leke**

**II.** Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**  
**Gaspër TOPOLLAJ**

**KRYETARI**  
**Aleksandër PICAKU**

**Paraqiten projekti**

Dr.zhvill.ekon.tatim taksa:V.Gjoka

Përgj.sekt.njes.kord.int.europ dhe proj:Gj.Marfana

Përgj.sekt juridik dhe prok:M.Topollaj

**KRYETARI**

**Albert MËLYSHI**



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2254 Prot.

Rrëshen, me 21.05.2026

**Lënda:** Relacion Për Projekt-Vendimin “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026, sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr.6822/1 prot., datë 04.05.2026, me objekt “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, për pagesë TVSH dhe bashkëfinancim për projektet “Mirdita Junik” dhe “Effort”

**Drejtuar:** KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË

Të nderuar anëtarë!

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, si dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, Bashkia Mirditë paraqet për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin për shtesë në buxhetin e vitit 2026.

Ky projekt-vendim hartohet në vijim të shkresës së Ministrisë së Financave nr. 6822/1 prot., datë 04.05.2026, me objekt “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, nëpërmjet së cilës Bashkisë Mirditë i akordohen fonde për mbulimin e detyrimeve financiare që lidhen me pagesën e TVSH-së dhe bashkëfinancimit vendor për projektet me financim të huaj “Mirdita-Junik” dhe “EFFORT” të financuar nga skema e granteve IPA Shqipëri-Kosovë.

Projektet në fjalë financohen në kuadër të Programit Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë, të mbështetur nga Bashkimi Evropian, ndërsa fondet për TVSH dhe bashkëfinancim mbulohen nga buxheti i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC).

Projektet kanë rëndësi të veçantë për Bashkinë Mirditë, pasi kontribuojnë drejtpërdrejt në:

- zhvillimin e turizmit lokal dhe ndërkufitar;
- promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe energjetike;
- rritjen e kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimit ndërvendor;
- nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social në territorin e Bashkisë Mirditë.

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email: [bashkia@bashkiamirdite.gov.al](mailto:bashkia@bashkiamirdite.gov.al)

tel & fax : +355 216 22233

web: [www.bashkiamirdite.gov.al](http://www.bashkiamirdite.gov.al)

Bazuar në kontratat aktive, faturat e realizuara dhe planin e prokurimit të projekteve, rezulton se vlera totale e TVSH-së për të dy projektet është 14,651,561 lekë, ndërsa vlera totale e bashkëfinancimit është 8,680,228 lekë.

### **Projekti “MIRDITA JUNIK”**

Ky projekt parashikon ndërhyrje të rëndësishme në promovimin turistik dhe zhvillimin e infrastrukturës rekreative, duke përfshirë:

- organizimin e aktiviteteve dhe eventeve promovuese;
- hartimin e materialeve të komunikimit dhe promovimit;
- projektimin dhe ndërtimin e shtegut turistik “Mendja e së Ardhmes”;
- shërbime mbikëqyrjeje dhe kolaudimi të investimit.

Në kuadër të këtij projekti:

- Vlera totale e TVSH-së rezulton në: **5,662,246 lekë**
- Vlera totale e bashkëfinancimit: **4,087,519 lekë**

Totali i projektit për mbulim financiar është:

**9,749,786 lekë**

### **Projekti “EFFORT”**

Ky projekt fokusohet në ndërhyrje për eficiencën energjetike dhe përmirësimin e infrastrukturës publike, duke përfshirë:

- izolimin termik të ndërtesës “Info Kulla”;
- blerjen dhe instalimin e paneleve diellore dhe pompave termike;
- mbikëqyrje dhe kolaudim të investimeve;
- përmirësimin e performancës energjetike të objekteve publike.

Në kuadër të këtij projekti:

- Vlera totale e TVSH-së rezulton në: **8,989,314 lekë**
- Vlera totale e bashkëfinancimit: **4,592,688 lekë**

Totali i projektit për mbulim financiar është:

**13,582,002 lekë**

### **Përmbledhje financiare**

- Totali i projektit “Mirdita Junik”: **9,749,786 lekë**
- Totali i projektit “EFFORT”: **13,582,002 lekë**

**Totali i shtesës në buxhet:**

**23,331,786 lekë**

Miratimi i këtij projekt-vendimi është i domosdoshëm për:

- reflektimin në buxetin vendor të transfertës së akorduar nga Ministria e Financave;
- garantimin e vazhdimësisë së zbatimit të projekteve;

- përmbushjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga kontratat dhe marrëveshjet e financimit;
- realizimin në kohë të procedurave financiare dhe të investimeve të planifikuara;
- shmangien e pengesave administrative dhe financiare gjatë zbatimit të projekteve.

Për sa më sipër, kërkohet miratimi nga Këshilli i Bashkisë Mirditë i projekt-vendimit “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026, sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr.6822/1 prot., datë 04.05.2026, me objekt “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, për pagesë TVSH dhe bashkëfinancim për projektet “MIRDITA - JUNIK” dhe “EFFORT”.

Ju faleminderit!

***Paraqiti Projektin:***

Njesia e Integritetit Evropian dhe Projekteve: P/Sek, **Gjovalin Marfana**

**KRYETARI**

**Albert MËLYSHI**





TABELA 1.1

TVSH SASPAK DHE BASHKEFINANCIM MIRDITA JUNIK  
PROGRAMI AD133

Funksioni 476, PRODUKTI V476AAB

## SEKTORI I INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE

| PLANI 2026                                                             |                    |                                          |                                      |            |                  |
|------------------------------------------------------------------------|--------------------|------------------------------------------|--------------------------------------|------------|------------------|
| Emertimi i shpenzimit                                                  | Llogaria Ekonomike | Transferte e Pakushtezuar e Pergjithshme | Transferte e Pakushtezuar Sektoriale | Te ardhura | TOTALI           |
| Shpenzime operative                                                    | 602                |                                          |                                      |            |                  |
| Organizim i 2 Eventeve (sherbim)                                       |                    | 399,504                                  |                                      | -          | 399,504          |
| Organizim i 2 Eventeve (sherbim)                                       |                    | 399,505                                  |                                      | -          | 399,505          |
| Logo, plan komunikimi, çanta te riperdorshme, fletore, broshura, baner |                    | 141,247                                  |                                      | -          | 141,247          |
| <b>TOTAL TVSH 602</b>                                                  |                    | <b>940,256</b>                           | -                                    | -          | <b>940,256</b>   |
| Aktivite                                                               |                    | 500,021                                  |                                      | -          | 500,021          |
| <b>TOTAL BASHKEFINANCIM 602</b>                                        |                    | <b>500,021</b>                           | -                                    | -          | <b>500,021</b>   |
| <b>shuma 602</b>                                                       |                    | <b>1,440,277</b>                         | -                                    | -          | <b>1,440,277</b> |
| <b>INVESTIME</b>                                                       |                    | -                                        |                                      | -          | -                |
| Projektim i objektit "Mendja e se ardhmes"                             | 230                | 296,715                                  |                                      | -          | 296,715          |
| PC, Monitor, Camera, Dron, USB                                         | 231                | 160,785                                  |                                      | -          | 160,785          |
| Ndertimi Shtegu "Mendja e se ardhmes"                                  |                    | 4,160,499                                |                                      | -          | 4,160,499        |
| Kolaudim Shtegu "Mendja e se ardhmes"                                  |                    | 7,820                                    |                                      | -          | 7,820            |
| Mbikqyrje Shtegu "Mendja e se ardhmes"                                 |                    | 96,171                                   | -                                    | -          | 96,171           |
| <b>TOTAL TVSH 231</b>                                                  |                    | <b>4,721,990</b>                         | -                                    | -          | <b>4,721,990</b> |
| Ndertimi i shtegut                                                     |                    | 3,587,519                                | -                                    | -          | 3,587,519        |
| <b>TOTAL BASHKEFINANCIM 231</b>                                        |                    | <b>3,587,519</b>                         | -                                    | -          | <b>3,587,519</b> |
| <b>TOTAL TVSH</b>                                                      |                    | <b>5,662,246</b>                         | -                                    | -          | <b>5,662,246</b> |
| <b>TOTAL BASHKEFINANCIM</b>                                            |                    | <b>4,087,540</b>                         |                                      |            | <b>4,087,540</b> |
| <b>TOTALI (602+230+231)</b>                                            |                    | <b>9,749,786</b>                         |                                      |            | <b>9,749,786</b> |

Pergj.sekt fin/buxhet

Flora Fufi

Dr.zhvill.ekon dhe tatim taksave

Vjollca Gjoka

KRYETARI

Albert MELYSHI





TABELA 1.2

## TVSH SASPAK DHE BASHKEFINANCIM EFFORT

PROGRAMI AB133

Funksioni 644, PRODUKTI V644AAB

## SEKTORI I INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE

| PLANI 2026                                                                           |                    |                                          |                                      |            |                   |
|--------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|------------------------------------------|--------------------------------------|------------|-------------------|
| Emertimi i shpenzimit                                                                | Llogaria Ekonomike | Transferte e Pakushtezuar e Pergjithshme | Transferte e Pakushtezuar Sektoriale | Te ardhura | TOTALI            |
| <b>INVESTIME</b>                                                                     |                    | -                                        |                                      | -          | -                 |
| Hartim I projektit per izolim termik Info Kulla                                      | 231                | 45,985                                   |                                      | -          | 45,985            |
| Izolim termik I Nderteses Info Kulla                                                 | 231                | 766,021                                  |                                      | -          | 766,021           |
| Hartim I projektimit "Blerje dhe instalimit te paneleve diellore dhe pompes termike" | 230                | 229,200                                  |                                      | -          | 229,200           |
| Kolaudimi i Infokulles                                                               | 231                | 1,749                                    |                                      | -          | 1,749             |
| Mbikqyrje Infokulla                                                                  | 231                | 20,125                                   | -                                    | -          | 20,125            |
| Mbikqyrje e Paneleve                                                                 | 231                | 152,800                                  | -                                    | -          | 152,800           |
| Kolaudimi i paneleve                                                                 | 231                | 2,500                                    |                                      |            | 2,500             |
| Blerja dhe instalimii pajisjeve_Mirdite                                              | 231                | 7,770,934                                |                                      |            | 7,770,934         |
| <b>TOTALI I TVSHS</b>                                                                |                    | <b>8,989,314</b>                         | -                                    | -          | <b>8,989,314</b>  |
| Ndertimi i paneleve                                                                  | 231                | 4,225,388                                |                                      |            | 4,225,388         |
| Kolaudimi i paneleve                                                                 | 231                | 137,700                                  |                                      |            | 137,700           |
| Mbikqyrje panelet                                                                    | 231                | 229,600                                  |                                      |            | 229,600           |
| <b>TOTALI I BASHKEFINANCIMIT</b>                                                     |                    | <b>4,592,688</b>                         | -                                    | -          | <b>4,592,688</b>  |
| <b>TOTALI (230+231)</b>                                                              |                    | <b>13,582,002</b>                        | -                                    | -          | <b>13,582,002</b> |

Pergj.sekt fin/buxhet  
Flora Fufi

Dr.zhvill.ekon dhe tatim taksave  
Vjollca Gjoka

KRYETARE  
Alber







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MIRDITË**

**DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TATIM TAKSAVE**

Nr. 1316 Prot.

Rrëshen, me 13.03.2026

**Lënda:** Kërkesë për mbështetje për projektet “Mirdita Junik” dhe “Effort” të financuar nga Programi IPA II Shqipëri-Kosovë.

**ZNJ. ERIDANA ÇANO – DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
AGJENCIA SHTETËRORE PËR PROGRAMIMIN STRATEGJIK DHE  
KOORDINIMIN E NDIHMËS**

**Adresa: Rruga Kuvajt 1001 Tirana, Albania**

I/E nderuar Znj. Çano,

Më lejoni t'ju përcjell falenderimet dhe mirënjohjen për mbështetjen që u jepni bashkive në zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian.

Bashkia ka lidhur kontratat e grantit Nr. IPA/2023/450-172 “EFFORT” DHE IPA/2023/449-275 “Mirdita Junik” të financuar nga Programi IPA II BNK Shqipëri-Kosovë.

Mbështetur në Ligjin Nr. 87/2025 PËR BUXHETIN E VITIT 2026, Udhëzimi nr. 2 datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, shtojca B, në tabelën e mëposhtme po ju paraqesim vlerën totale të TVSH-së së akumuluar për Projektet “Effort” dhe “Mirdita-Junik” për të cilet po ju kërkojmë mbështetje për pagesta e TVSH-së dhe bashkëfinancimin sipas akteve dhe faturave bashkëlidhur:

| Kontrata                                                 | Vlera totale në Euro | Financim nga Granti                    | Bashkefinancim Bashkia             | TVSH Bashkia                                                                                                                                                 |
|----------------------------------------------------------|----------------------|----------------------------------------|------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kontratën e grantit Nr.IPA/2023/449-275 “Mirdita Junik”. | 1,270,588.24 Euro    | 1,080,000.00 Euro Total                | 73,321.65 Euro Total               | <b>5,664,145.40 Lekë</b> për faturat bashkëlidhur për vitin 2024-2025-2026 (Fat nr.516, Fat nr.393, Fat nr. 21, Fat nr. 232, Fat nr.13+ kontratat në zbatim) |
|                                                          |                      | <b>488,810.98 Euro Bashkia Mirditë</b> | 42,401.65 Euro kërkohet nga Saspac |                                                                                                                                                              |

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHËN

email: [bashkia@bashkiamirdite.gov.al](mailto:bashkia@bashkiamirdite.gov.al)

tel & fax : +355 216 22233

web: [www.bashkiamirdite.gov.al](http://www.bashkiamirdite.gov.al)

|                                 |                   |                                                                |                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|---------------------------------|-------------------|----------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Nr.IPA/2023/450-172<br>"EFFORT" | 1,411,765<br>Euro | 1,200,000 Euro<br><b>556,014.71</b><br>Euro Bashkia<br>Mirditë | 83,402 Euro<br>Totali                                                                                  | <b>1,180,943.546</b><br>Lekë për fatura<br>dhe kontrata të<br>lidhuran dhe ne<br>proces zbatimi<br>bashkëlidhur +<br>84,000 Euro *<br>96.4 (inforeuro<br>Mars 2026) =<br><b>8,097,600 lekë</b><br>per procedurën<br>që është në<br>proces për<br>vendosjen e<br>paneleve<br>diellore dhe një<br>pompe termike. |
|                                 |                   |                                                                | 47,642.21 Euro<br>kërkohet nga<br>Saspac                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Total i kërkuar për<br>2026     |                   |                                                                | <b>90,043.86 Euro</b><br>*96.4 (inforeuro<br>per muajin Mars<br>2026 =<br><b>8,680,228.104</b><br>Lekë | <b>14,942,688.946</b><br>Lekë                                                                                                                                                                                                                                                                                  |

Sipas tabelës së mësipërme, Bashkia kërkon të përfitojë një fond nga buxheti i shtetit për vitin 2026, e parashikuar në Ligjin nr. 87 "Për buxhetin e vitit 2026", neni 11, pika 6, në masën **14,942,688.946 Lekë** për rimbursimin e TVSH-së për të dy projektet e paraqitura në tabelë dhe për bashkëfinancimin e këtyre projekteve **90,043.86 EURO e barabartë me 8,680,228.104 Lekë duke marrë si referencë këmbimi inforeuro për muajin Mars.**

Shuma që kërkohet ka qenë e pamundur të planifikohet në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë për shkak të ardhurave të ulëta që ka bashkia dhe sepse edhe për bashkëfinancimin në masë 25 % e Projektit RELOAD 3 do ta mbulojmë duke rialokuar nga trashëgimet e vitit 2025 pa patur mundësi financiare për të shtuar më shumë për projektet e tjera.

Ndodhur në këto rrethana kërkojë marrjen parasysh të kërkesës dhe vënien në dispozicion të Bashkisë shumën prej **14,942,688.946 Lekë** për rimbursimin e TVSH-së dhe bashkëfinancimin e këtyre projekteve **90,043.86 EURO e barabartë me 8,680,228.104 Lekë** për këto projekte.

Bashkëngjitur gjeni:

- Kontratat e grantit
- Faturat përkatëse

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: [bashkia@bashkiamirdite.gov.al](mailto:bashkia@bashkiamirdite.gov.al)

tel & fax : +355 216 22233

web: [www.bashkiamirdite.gov.al](http://www.bashkiamirdite.gov.al)

- Kontratat me operatorët ekonomik që janë në proces.
- Buxhetin e projektit EFFORT ku identifikohet zëri 6.1 "Blerje dhe instalimi i pajisjeve në Mirditë" dhe 6.1.1 "Blerja e 1 pompe elektike për ngrohje në 1 godinë pilote" zëra që i referohet Paneleve Diellore dhe Pompes termike që do vendosen në godinat publike të Bashkisë Mirditë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe gadishmërinë Tuaj,

Konceptoi: Gj. Marfana

Konfirmoi: V. Gjoka



ADRESA: SHESH "ABAT DOÇI", RRËSHËN

email: [bashkia@bashkiamirdite.gov.al](mailto:bashkia@bashkiamirdite.gov.al)

tel & fax : +355 216 22233

web: [www.bashkiamirdite.gov.al](http://www.bashkiamirdite.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MIRDITË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, JURIDIKE DHE MARREDHËNJEVE ME QYTETARËT

NJËSIA PËR KOORDINIMIN E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE

Nr. 2249 Prot.Rrëshen, me 20.05.2026

**Lënda:** Paraqitje të dhënash sipas faturave, kontratave të lidhura aktive dhe planit të prokurimit për TVSH dhe bashkëfinancim në kuadër të projekteve "Mirdita -Junik" dhe "EFFORT"

**Drejtuar:** DREJTORISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TATIM TAKSAVE

Në vijim të shkresës së Ministrisë së Financave nr. 6822/1 prot., datë 04.05.2026, me lëndë "Transferim fondi për shpenzime kapitale", si dhe në funksion të procedimit financiar të fondeve përkatëse, po ju përcjellim të dhënat sipas faturave për TVSH dhe bashkëfinancim për projektet me financim të huaj në kuadër të projekteve "Mirdita -Junik" dhe "EFFORT" të mbështetura nga Programi Ndërkufitar Shqipëri – Kosovë i financuar nga Bashkimi Evropian dhe që mbështetet për bashkëfinancimin dhe TVSH nga buxheti i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC).

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën bashkëlidhur, rezulton se vlera totale e TVSH-së për të dy projektet është 14,651,561 lekë, ndërsa vlera totale e bashkëfinancimit është 8,680,228 lekë.

**Projekti "MIRDITA JUNIK"**

| Nr.    | Pershkrimi i mallit/shërbimit                                          | TVSH      | Emri                 |     |
|--------|------------------------------------------------------------------------|-----------|----------------------|-----|
| 1      | PC, Monitor, Camera, Dron, USB                                         | 160,785   | OPTIMA COMMUNICATION | 231 |
| 2      | Organizim i 2 Eventeve (shërbim)                                       | 399,504   | PIK                  | 601 |
| 3      | Organizim i 2 Eventeve (shërbim)                                       | 399,505   | PIK                  | 601 |
| 4      | Logo, plan komunikimi, çanta të ripërdorshme, fletore, broshura, baner | 141,247   | PIK                  | 602 |
| 5      | Projektim i objektit "Mendja e së ardhmes"                             | 296,715   | PALMA CONSTRUCTION   | 230 |
| 6      | Ndertimi Shtegu "Mendja e së ardhmes"                                  | 4,160,499 | ASI INVEST SHPK      | 23  |
| 7      | Kolaudim Shtegu "Mendja e së ardhmes"                                  | 7,820     | MIKI CONSULTING      | 23  |
| 8      | Mbikqyrje Shtegu "Mendja e së ardhmes"                                 | 96,171    | BN PROJECT           | 23  |
| TOTALI |                                                                        | 5,662,246 |                      |     |

ADRESA SHENHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email: [bashkia@bashkiamirdite.gov.al](mailto:bashkia@bashkiamirdite.gov.al)

tel &amp; fax : +355 216 22233

web: [www.bashkiamirdite.gov.al](http://www.bashkiamirdite.gov.al)



| Nr            | Bashkefinancim     | Shuma            |
|---------------|--------------------|------------------|
| 1             | Aktivitetet        | 500,021          |
| 2             | Ndertimi i shtegut | 3,587,519        |
| <b>TOTALI</b> |                    | <b>4,087,519</b> |

### Projekti "EFFORT"

| Nr            | Pershkrimi i mallit/sherbitimit                                                      | TVSH             | Emri               |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------|------------------|--------------------|
| 1             | Hartim i projektit per izolim termik Info Kulla                                      | 45,985           | PALMA CONSTRUCTION |
| 2             | Izolim termik i nderteses Info Kulla                                                 | 766,021          | Ndertuesi 2000     |
| 3             | Hartim i projektimit "Blerje dhe instalimit te paneleve diellore dhe pompes termike" | 229,200          | ZENIT&CO           |
| 4             | Kolaudimi i Infokulles                                                               | 1,749            | Project daluz 2019 |
| 5             | Mbikqyrje Infokulla                                                                  | 20,125           | Miki Consulting    |
| 6             | Mbikqyrje e Paneleve                                                                 | 152,800          | ZENIT&CO           |
| 7             | Kolaudimi i paneleve                                                                 | 2,500            |                    |
| 8             | Blerja dhe instalimii pajisjeve Mirdite                                              | 7,770,934        |                    |
| <b>TOTALI</b> |                                                                                      | <b>8,989,314</b> |                    |

| Nr            | Bashkefinancim       | Shuma            |
|---------------|----------------------|------------------|
| 1             | Ndertimi i paneleve  | 4,225,388        |
| 2             | Kolaudimi i paneleve | 137,700          |
| 3             | Mbikqyrje panelet    | 229,600          |
| <b>TOTALI</b> |                      | <b>4,592,688</b> |

PËRGJEGJËS  
GJOVALIN MARFANA





Nr. 2004/P157  
07.05.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE PUBLIKE



Nr. 6822/ 4 prot.

Tiranë, më 4 . 5 . 2026

Lënda: Transferim fondi për shpenzime kapitale.

MINISTRISË SË FINANCAVE  
Tiranë  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT  
Tiranë  
DEGËS SË THESARIT TIRANË  
Tiranë  
DEGËS SË THESARIT MIRDITË

Mirditë

Për dëgjim: AGJENCISË SHTETËRORE TË PROGRAMIMIT STRATEGJIK  
DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS (SASPAC)

Tiranë


BASHKISË MIRDITË ✓

Në zbatim të ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, të Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", si dhe në mbështetje të shkresës së Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) me nr. 554/1 prot., datë 15.04.2026, miratojmë transferimin e fondeve për shpenzime kapitale, sipas tabelës bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

MINISTRI

Petrit Malaj



Talshet e transferimit të fondëve për shpenzimet kapitale

Ne lke

| Entiteti | Ministria e<br>Kujës | Kodi i institucionit | Emërtimi i institucionit       | Kapitulli | Programi | Logariti<br>Ekonomike | Kodi i D. së<br>Itiesarit | Kodi i<br>produktit | Emërtimi i produktit                                                                       | Buxheti 2026 |
|----------|----------------------|----------------------|--------------------------------|-----------|----------|-----------------------|---------------------------|---------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
|          |                      |                      |                                |           |          |                       |                           |                     | Pakësohet                                                                                  | 23,331,789   |
| 001      | 10                   | 1010001              | Aparati Ministres së Financave | 04        | 01130    | 2310000               | 3335                      | 18BS007             | TVSH, (Parafinancim, bashkëfinancim, pagesë TVSH-je dhe Detyrim Doganor)                   | 23,331,789   |
|          |                      |                      |                                |           |          |                       |                           |                     | Shtohet                                                                                    | 23,331,789   |
| 133      | 00                   | 2133001              | Bashkia Mirditë                | 01        | 04960    | 6040000               | 2026                      | 90005AD             | Fond MFE për pagesën e TVSH për projektet me financim të huaj "Effort" dhe "Mirdita Junx"  | 14,651,561   |
| 133      | 00                   | 2133001              | Bashkia Mirditë                | 01        | 04960    | 6040000               | 2026                      | 90005AC             | Fond MFE për bashkëfinancimin e projekteve me financim të huaj "Effort" dhe "Mirdita Junx" | 8,680,228    |